

## **Pyetje nga lenda Teknologjia Informatike** **Bazat e te dhenave**

### **1. Çka eshte baza e te dhenave?**

Bazë e të dhënave është çfarëdo grumbulli informatash të organizuara në grup. Informatat duhet të jenë të organizuara ashtu që lehtë mund të ju qasemi.

### **2. Cilat jane objektet ne bazat e te dhenave?**

- a) Tabelat (Tables)
- b) Pyetësorët (Queries)
- c) Format (Forms)
- d) Raportet (Reports)
- e) Faqet (Pages)
- f) Makrot (Macros)
- g) Modulet (Modules)

### **3. Çka jane tabelat?**

Ky objekt definon strukturën e një baze në Access. Tabelat përmbajnë numër të madh të dhënash në rreshta dhe në kolona. Këto të dhëna mund të futen, ndryshohen, ruhen dhe të kthehen.

### **4. Per çka sherben Field Name, Data Type dhe Description?**

### **5. Çka eshte Pyetesori?**

Është mënyrë për kërkimin e informacioneve në tabelë. Kur ekzekutojmë një pyetësor, të dhënat paraqiten në të quajturin Recordset. Pastaj këto të dhëna mund të ndryshohen ose të shtypen (printohen).

### **6. Çka eshte Forma?**

Lejon futjen e të dhënave, shikimin si dhe ndryshimin e tyre. Forma mund të shfrytëzohet si alternativë për paraqitjen e të dhënave në rreshta dhe në kolona.

**7. Çka është Raporti?**

Është dizajn për të dhënat që do të shtypen(printohen).Raportet përfshijnë raportet nga baza e të dhënave.Në raporte poashtu mund të kryhen llogaritje matematikore.

**8. Çka është Faqja?**

Është një web faqe që mund t'i qasemi dhe të punojmë me bazën e të dhënave në Access përmes internetit dhe intranetit.

**9. Çka është Makro?**

Është një varg i urdhërave të cilat ekzekutohen si një.

**10. Çka është Moduli?**

Ky objekt përmban aplikacione të Visual Basic me të cilat mund të ndryshojmë funksionet në bazë të të dhënave.

**11. Çka është Text**

Text është një tip i të dhënave që përmban çdo kombinim të shkronjave, numrave, shenjave të pikësimit dhe hapësirës.Ku si mundësi e parazgjedhur është 50 karakter ndërsa maksimumi është 255 karakter.

**12. Çka është Short Text?**

Sherben per shenim te nje teksti te shkurter i cili permban deri 255 karaktere.

**13. Çka është Long Text?**

Sherben per shenim te nje teksti i cili permban mbi 255 karaktere.

**14. Çka është Number?**

Fusha Number mund të përmbajë vetëm karakter numerik, presjen (për mijëshe), pikën (për pikë decimale) dhe minus (vijë, për shenjë të numrave negativë). Number shfrytëzohet vetëm kur kemi të bëjmë me kalkulime me vlerat e fushave.P.SH. edhe pse zip kodi dhe numri i telefonit përmbajnë numra ato nuk do t'i përdorim për kalkulime.Për atë ato nuk duhen të jenë të tipit Number.

**15. Çka është Date/Time?**

Date/Time përmbanë datën dhe/ose kohën.Access-i automatikisht vlerëson futjen e datës duke u siguruar se është valide.P.SH. Nëse dojmë të fusim datën 31/02/1999

Access-i nuk do ta lejoj sepse muaji Shkurt nuk i ka 31 ditë. Fusha Date/Time është e përdorshme për kalkulimin e datës dhe kohës.

#### **16. Çka është Currency?**

Currency është e ngjashme me fushën Number dhe mund të përdoret për kalkulime. Numrat në këtë fushë paraqiten automatikisht me shenjën e dollarit.

#### **17. Çka është AutoNumber**

Tipi i të dhënave AutoNumber automatikisht cakton numrin unik (prej 1) secilës të dhënë. Nuk mundemi të fusim vlerë në një fushë ku më parë Access-i ka caktuar vlerën. Këtë tip të të dhënave e përdorim kur dojmë që të kemi identifikim unik për secilën të dhënë.

#### **18. Çka është Yes/No?**

Fusha Yes/No shënon dy kondita PO dh JO. Ky tip i të dhënave përdoret kur ekzistojnë vetëm dy mundësi (P.SH. e saktë dhe jo e saktë) për vlerën e fushës.

#### **19. Çka është Hyperlink?**

Fusha Hyperlink shfrytëzohet për lidhjen me ndonjë faqe në internet, document të Word-it në intranet ose edhe formë në bazë të të dhënave. Hyperlink mund të përmbajë përshkrim, adresë dhe nën adresë. Secila pjesë është e ndarë me shenjën # dhe mund të përmbajë 2.048 karakter.

#### **20. Çka janë Pyetesoret?**

Fjala QUERY (PYETËSORË) që do të thotë pyetje ose kërkesë. Pyetëtori në Access është pyetja që bëhet për informacionin që gjendet në tabelë. Pyetëtori mund të jetë i thjeshtë, të kërkoj të dhëna vetëm nga një tabelë dhe mund të jetë i përbërë të kërkoj të dhëna në shumë tabela në dallim nga filterët që u përdorën te tabelat, ku të dhënat mund të nxirren nga vetëm një tabelë.

Pyetëtori nuk përmban të dhëna, ai përmban instruksione të cilat Access-i i përdorë për të nxjerr të dhënat që u përgjigjen atyre instruksioneve. Prandaj kur të shtojmë ndonjë të dhënë në tabelë nuk kemi nevojë që të bëjmë ndryshime edhe në

pyetësor. Të dhënat që paraqiten pas ekzekutimit të pyetësorit quhen bashkësi e të dhënave (Recordset).

**21. Te krijohet tabela Klientet, ku brenda saj do te kete kolonen Pagesa dhe kolonen Borxhi. Te llogaritet diferenca e kolones Pagesa dhe kolones Borxhi.**

**Zgjidhje:**

